



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 01/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga :Vedat Poterqoi Kryetari i vetëm i panelit shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE)“Komtel Project Engineering” sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Makinë për larjen e rrobave(Industriale) Ri ri-tender “me nr. të prokurimit 651-22-12013-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Gjilan, me datën 21.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Anulohet** aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizim me Makinë për larjen e rrobave(Industriale) Ri ri-Tender”me nr. të prokurimit 651-22-12013-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Kuvendi Komunal Gjilan.

2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 13.12.2022, Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin Mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës për aktivitetit të

prokurimit me titull: “Furnizim me Makinë për larjen e rrobave(Industriale)Ri ri-Tender”, me nr. të prokurimit 651-22-12013-1-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE “Oni Design”.

Me datë 16.12.2022, Operatori Ekonomik “Komtel Project Engineering” sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Gjilan, me datë 22.12.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar Njoftimin Mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues të datës 13.12.2022.

Me datën 04.01.2023 Operatori Ekonomik “Komtel Project Engineering” sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 01/2023, kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, me afat 60 ditë, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 €, ekzekutimi i kontratës: thirrje/porosi, përderisa kriter i dhënies ka qenë çmimi më i ulët.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13 janar 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 25 janar 2023 AK Kuvendi Komunal Gjilan ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa me datë 13 janar 2023 OE “Komtel Project Engineering” sh.p.k ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 13.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE “Komtel Project Engineering” sh.p.k të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 13.12.2022 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE “Komtel Project Engineering”sh.p.k. Prishtinë

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumentacionit në dispozicion lidhur me pretendimet e OE ankues, vlerëson se:

Në pretendimin nr. 1 (LPP/Neni 1-Qëllimi), AK e ka respektuar rregullën e kriterit çmimi më i ulët, mirëpo nuk mund të konsiderohet e pranueshme, për shkak se nuk janë plotësuar dokumentet, siç është Deklarata e Specifikave e cila është KUSHT ADMINISTRATIV, kështu me këtë rast AK nuk e ka respektuar nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së i cili parasheh se: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Rrjedhimisht OE i propozuar për shpërbllim me kontratë është administrativisht dhe teknikisht i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 2 (LPP/Neni 7-Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) të OE ankues se AK duhet të vlerësoj të gjitha kompanitë në formë të barabartë dhe jo-diskriminuese qëndron pasi që nëse shikohet modeli i ofertuar nga OE i rekomanduar për t’u shpërblyer me kontratë për Pozicionin Nr. 2 përveç që është më vëllim të kazanit më të vogël, nuk ka të dhëna fare për numrin e shpejtësisë së motorit RPM - kërkesë kjo po ashtu në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 3 (LPP/Neni 28-Specifikimet Teknike) të OE ankues se AK ka shpërblyer OE fitues me kontratë i cili ka ofertuar me makina të markës KROMLUKS përkatësisht modelin KOCYS-E/20 për pozicionin Nr. 1 dhe KCKM-E/20 për pozicionin Nr. 2 të cilat kanë specifika më të vogla se kërkesat minimale të kërkuara në FDT qëndron. Modeli i kërkuar me FDT për pozicionin Nr. 1 është modeli TOLKAR HYDRO me vëllim të kazanit të tharësit 208/ ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar makinë me vëllim të kazanit të tharësit 200/, pra vëllim më të vogël se kërkesa minimale e kërkuar në FDT. Te “Technical Specifications” shihen po ashtu dy modele të makinave, njëra që funksionon me energji elektrike dhe tjetra me avull, përderisa të dhënat teknike bazike janë ndër kërkesat minimale të kërkuara në FDT. Për referencë, më poshtë është bashkëngjitur fotografia me specifikacione.



TECHNICAL SPFCIFICATIONS

Model	KCKM-E720	KCKM-t3Z2t3
Code	8004020102	8004020108
Heating System	Electric	Steam
Capacity	Kg/Load	20
Drum Diameter	mm _____	940
Drum Volume	Lt _____	400

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 4 (LPP/Neni 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të OE ankues i cili pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur këtë nen, sepse vlerësimi nuk është i drejtë dhe se OE i propozuar për shpërbllim me kontratë është administrativisht dhe teknikisht i papërgjegjshëm qëndron, për shkak se nuk ka ofruar të dhëna të sakia teknike të modeleve të ofertuara, me ç’rast nuk janë plotësuar dokumentet, siç është Deklarata e Specifikave e cila është KUSHT ADMINISTRATIV, pra nuk është në harmoni me

kërkesat në DT. Me këtë rast, sipas nenit 69 të LPP-së, paragrafi 7, parashihet se Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumentacione) të saktësuara në këtë nen, i nevojiten.

Më tutje, duhet theksuar se parimet kryesore të procedurës së vlerësimit, sipas LPP-së, ndër të tjera janë që:

[...] Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kriterëve të specifikuar të dhënies së kontratës dhe se vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë / dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.

Bazuar në nenin 4.1.37 të LPP-së parashihet se: tenderi i cili nuk është në përputhje me a) dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktua e, b) kërkesat e legjislacionit relevant të Kosovës ose të cilët c) përndryshe nuk përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues siç janë specifikuar në dosjen e tenderit, konsiderohet tender i papërgjegjshëm.

Prandaj, në tërësi, Autoriteti Kontaktues ka shkelur nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së i cili parasheh se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit,

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në konstatimet e lartpërmendura në ekspertizë, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE “Komtel Project Engineering” Sh.p.k. të aprovohet si e bazuar, dhe propozon që të anulohet Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nga AK dhe lënda të kthehet në rivlerësim në mënyrë që të rishqyrtohet procedura e prokurimit që garanton barazi dhe integritet ndërmjet operatorëve ekonomik.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi

Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në specifikat teknike të detyrueshme të kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe në katalogun e ofruara nga OE i rekomanduar por edhe OE ankues shihet qartë se asnjëri nuk është i përgjegjshëm ngase vëllimin e kazanit të makinave nuk është konform specifikimet teknike të detyrueshme. Andaj, PSH erdhi në përfundim që për këtë aktivitet të prokurimit janë plotësuar kushtet e nenit 62 të LPP-së që në mungesë të ofertave të përgjegjshme aktiviteti i prokurimit të anulohet.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Kuvendi Komunal Gjilan
- 1x1 OE "Komtel Project Engineering" sh.p.k, me seli në Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.